

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË BERAT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Berat**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, funksionimi i policisë, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, etj.”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 62, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 163/10, datë 30.06.2014, i ka rekomanduar z. Fadil Nasufi, Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Bashkia Berat te marre masa për zgjidhjen e problemeve qe paraqet Parku Udhëtareve Berat njësi vartëse e saj, i cili shoqërohet me humbje te njëpasnjëshme për 3 vite radhazi dhe me një borxh publik me vlerën 7,381,090 leke te krijuar deri ne fund te vitit 2013, për detyrime fiskale dhe sigurime shoqërore ndaj shtetit, sipas shkresës Parkut Udhëtare nr. 21, date 6.3.2014.

Menjëherë

2. Bashkia të marrë masa dhe të reduktoj shpenzimet në programin buxhetor për pritje-përcjellje dhe aktiviteteve në kuadër të trashëgimisë kulturore si qytet i mbrojtur nga UNESCO, pasi përballimi i shpenzimeve të këtij lloji i takojnë Ministrisë së Kulturës dhe Institucioneve të nën varësive së saj dhe jo pushtetit vendor, sipas kapitullit II. 3 “Buxhetit vendor” të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*.

Në vazhdimësi

3. Drejtoria e Planifikimit te territorit të marrë këto masa:

-Në praktikatat e dhënies të lejeve të ndërtimit kërkesat për leje sheshi, të bëhet protokollimi dhe të ndiqen afatet, sipas studimeve pjesore të miratuara.

-Në praktikatat e dhënies së lejeve të përdorimit, të kërkohet dokumentacioni që vërteton kryerjen e punimeve të infrastrukturës inxhinierike, për adaptim banese të merret më parë vendim për ndryshim destinacioni nga banesë- lokal.

-Për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë të merren masa për llogaritjen sipas çimeve të Entit Kombëtar të Banesave.

Të merren masa që të mos miratohen leje Përdorimi në rast se subjekti sipërmarrës nuk ka shlyer detyrimet Tatimore.

Vazhdimisht

4. Bashkia Berat të rishikoj strukturën dhe emërimin e punonjësve të INUV, pasi struktura aktuale nuk ka përputhshmëri me kërkesat e neni 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *“Për Inspektimin e Ndërtimit”*.

Brenda muajit Gusht 2014

5. Bashkia Berat të merre të gjitha hapat ligjorë, për hartimin e dokumentacionit të lëvizjes, në Qendrën Ekonomike të Arsimit (njësi vartëse e Bashkisë) të gjitha furnizimet, e tërhequra nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Berat.

Brenda muajit Gusht 2014

6. Nga Qendra Ekonomike e Arsimit të merren masa dhe të sistemohet inventari kontabël me inventarin fizik, llogaria” 218 “*Objekte Inventari*”, për inventarët që ju përkasin shkollave në administrim të QEA.

Brenda muajit Shtator 2014

7. Të merren masa për kryerjen e inventarëve të shkollave me komisione të veçanta, si dhe të rakordohet me Drejtorinë Arsimore Berat për diferencat që do rezultojnë, të nxirret përgjegjësia dhe të kryhen sistemimet kontable.

Brenda muajit Dhjetor 2014

8. Nga Qendra Ekonomike e Arsimit të ndërpriten pagesat direkte nga arka, pa kaluar të ardhurat në Degën e Thesarit Berat.

Menjëherë

9. Bashkia Berat të marrë të gjitha masat, për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në ZVRPP Berat, të 22 pronave pyje e kullota të kaluara në pronësi të bashkisë, sipas VKM nr. 222, datë 13.2.2008 “*Për kalimin përfundimtarë pyje dhe kullota në pronësi të Bashkisë Berat*”.

Brenda muajit Shtator 2014

10. Bashkia Berat të marrë masa duke vlerësuar përmes një grupi pune dhe anëtarëve të INUV gjendjen faktiko juridike të truallit prej 100 m², i cili shfrytëzohet pa titull pronësie private nga ana e subjektit Dh.D. në zonën Tampon, sipas marrëveshjes me Drejtorinë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Berat. Gjithashtu për kohën e shfrytëzimit pa titull pronësie dhe sjelljes si posedues nga ana e subjektit të rillogaritit vlera e detyrimit për kohën e shfrytëzimit të paligjshëm deri me datën e konstatimit. Në rast cënimi të kritereve të ligjit nr 8405, datë 17.09.1998 “*Për Urbanistikën*”, i ndryshuar në zonat e mbrojtura, të zbatohen kopeyencat ligjore nga INUV.

Brenda muajit Shtator 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përbarimor, me qëllim **arkëtimit** e vlerës **59,733,391 lekë**, nga kjo:

a. 29,102,367 leke dëm ekonomik,

b. 30,631,024 leke mungesë të ardhurash,

konkretisht:

1. vlera 1,992,156 lekë, për zbulime me dëm ekonomik të lënë nga auditimet e mëparshme nga KLSH-ja dhe të pazbatuara nga Bashkia Berat, përkatësisht:

-vlera 764,597 lekë nga *shpk “B...”* për *punime te pakryera*, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, nenet 7,8,9,11,12,14, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit*” paragrafi I, pika 1,3,4, paragrafi II, pika 3,7 dhe “*Kushtet teknike te zbatimit*”,paragrafi I,5,3.

-vlera 1,048,527 lekë, detyrim të pa paguar gjatë marrjes së lejes së ndërtimit ne 11 raste, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “*Për urbanistikën*”,i ndryshuar,neni 51, me ligjin nr. 9632,datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave*”, i ndryshuar, neni 27, sipas pasqyrës nr. 1, date 20.10.2011.

-vlera 103,462 lekë përfaqëson mos arkëtimit e qirasë dhe kamatëvonesat për mospagimin në afat të tyre ne 10 raste, ne kundërshtim me vendimin e Këshillit te Ministrave nr. 1712, date

24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfi-teoze te pasurive shtetërore”, i ndryshuar, kreu VI, sipas pasqyrës nr. 2 date 20.10.2011 te raportit mëparshëm te auditimit.

- vlera 75,570 lekë, vlerë e pa likuiduar për energjinë elektrike nga Televizioni Publik Shqiptar në vitin 2010, për përdorimin e Repetitorit “K...” pronë e Bashkisë.

Brenda muajit Shtator 2014

2. vlera 457,969 lekë (209,059+248,910), zbulim me dem ekonomik i lënë nga auditimet e mëparshme nga KLSH-ja, për “**B...Company**” shpk per **punime te pakryera**, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, nenet 7,8,9,11,12,14, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” paragrafi I, pika 1,3,4, paragrafi II, pika 3,7 dhe “Kushtet teknike te zbatimit”, paragrafi I,5,3.

Brenda muajit Shtator 2014

3. vlera 1,485,575 lekë, nga **komisioni i KVO**, përkatësisht E.P., L.B., M.S., R.K., V.Z. dhe Kryetari i Autoritetit Kontraktor F.N. me nga **247,596 leke secili**, pasi kane shpallur padrejtësisht fitues 3 operatore ekonomik me vlera me te larta se ofertat me vlera me te ulëta, veprim ne kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit ne tender, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

Brenda muajit Shtator 2014

4. vlera 5,835,420 lekë, diferenca **paga përfituar tepër** për futbolliste e trajner te **KF Tomori**, për 3-mujorin e IV te vitit 2011, vitin 2012 dhe vitin 2013, ne kundërshtim me nenin 15 dhe 19 te VKM nr. 1619, date 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësjve qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve te organeve qeverisjes vendore”, me VKM nr. 566, date 14.7.2010, nr. 527, date 20.7.2011 dhe nr. 573, date 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi”, me nenet 97 dhe 160 “shpërblimi” etj te ligjit nr. 9901, date 14.4.2008 “Për Tregtaret e shoqëritë tregtare”, me nenin 18 “shoqëritë sportive” dhe nenin 36 kreu XI “Burimet e financimit” etj te ligjit nr. 9376, date 21.4.2005 “Për Sportin” i ndryshuar nje ligjin nr. 9816, date 22.10.2007, me nenin 2 “Qëllimi i krijimit shoqërisë” dhe nenin 6 “Objekti” etj te Akt Themelimit te Shoqërisë Aksionare ‘FK Tomori 1923”, me nenin 4 “Objekti i veprimtarisë” dhe nenin 6 “Objekti” etj si dhe me nenin 41/2 te Statusit te Shoqërisë Aksionare ‘FK Tomori 1923” SHA.

Brenda muajit Dhjetor 2014

5. Vlera 550,000 lekë, për sportistet e **KF Tomorit**, për **pagesa mbi kufirin ligjor**, për periudhën Janar-Maj 2011, pa kaluar ne shoqëri aksionare, ne kundërshtim me piken 15 dhe 18 te VKM nr. 1619, date 2.7.2008 i ndryshuar me VKM nr. 693, date 18.8.2010 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësjve te Qeverisje Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve te organeve te qeverisjes vendore” pika 9/h, konkretisht: A.B. 76,000 leke, A.B. 28,000 leke, A.G. 19,000 leke, E.M. 19,000 leke, R.H. 19,000 leke, M.M. 95,000 leke, E.Me. 9,000 leke, Th.A. 57,000 leke, B.A. 28,000 leke, A.K. 9,000 leke dhe vlera 199,000 leke, perkatesisht: B.D. 19,000 leke, A.M. 19,000 leke, E.C. 19,000 leke, D.R. 19,000 leke, G.A. 19,000 leke, F.T. 19,000 leke, E.F. 19,000 leke, E.C. 19,000 leke, A.K. 9,000 leke, F. K. 19,000 leke dhe M.H. 19,000 leke.

Brenda muajit Tetor 2014

6. Vlera 492,000 leke, për përfitim **dieta** sportistët e **KF Tomori**, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, nënpika 3.2 , konkretisht:

-vlera 27,000 leke për 27 sportiste me nga 1000 leke/Sicili, sipas listës bashkëngjitur mandatpagesës nr. 2, datë 17.09.2011 .

-vlera 78,000 lekë, për 26 veta të ekipit futbollit sipas listës bashkëngjitur mandatpagesës nr. 3, datë 25.09.2011, për 3,000 lekë/secili.

-vlera 28,600 leke për 26 sportiste me nga 1,100 leke/secili sipas listës bashkëngjitur mandatpagesës, nr. 8, datë 17.12.2011.

- vlera 80,000 lekë, gjithsej 26 veta të ekipit futbollit sipas listës bashkëngjitur mandatpagesës nr. 25, datë 11.05.2012 për 3,077 lekë/secili.

- vlera 73,600 lekë, gjithsej 25 veta të ekipit futbollit sipas listës bashkëngjitur mandat pagesës nr. 33, datë 01.12.2012, për 2,944 lekë/secili.

- vlera 50,400 lekë, gjithsej 21 veta të ekipit futbollit sipas listës bashkëngjitur mandatpagesës nr. 61, datë 20.12.2012, për 2,400 lekë/secili.

- vlera 72,000 lekë, gjithsej 24 veta të ekipit futbollit sipas listës bashkëngjitur mandatpagesës nr. 23, datë 29.8.2013 , për 3,000 lekë/secili.

- vlera 67,500 leke, për 27 veta te ekipit futbollit Tomori sipas listës emërore ngjitur dokumentit bankës Raiffaisen datë 27.03.2012.

Brenda muajit Tetor 2014

7. Vlera 15,000 leke, për përfitim tepër *shpërblime* te 3 personave te **KF Tomori**, mbi limitin ligjor 10 mije leke ne fund te vitit, përkatësisht E.M. 5000 leke, Th.A. 5000 leke dhe M.M. 5000 leke, ne kundërshtim me kërkesat e pikes 6 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimin fondit veçantë” i ndryshuar.

Brenda muajit Tetor 2014

8. Vlera 942,000 leke, për anëtarët e këshillit drejtues te **Parkut Udhëtareve**, për *paga te paligjshme* përfituar nga rritja e indeksimit te pagës se ulet, ne kushtet me humbje financiare për vitin 2011, 2012 dhe 2013, në kundërshtim me piken 3 te VKM nr. 317, date 8.7.1999 “Për shpërblimin e punës se punonjësve”, me piken 4 te VKM nr. 317, date 8.7.1999 “Për shpërblimin e punës se punonjësve”, me VKM nr. 566, date 14.7.2010, nr. 527, date 20.7.2011 dhe nr. 573, date 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi” dhe me nenin 19/4, me nenin 23/3 te ligjit nr. 7582, date 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, konkretisht S.M. 264,000 leke, V.T. 30,000 leke, S.H.36,000 leke, Ll.H. 126,000 leke, S.L. 126,000 leke, R.Gj. 180,000 leke dhe R.K. 180,000 leke.

Brenda muajit Tetor 2014

9. Vlera 25,000 leke, përfituar padrejtësisht *shpërblime* nga 3 punonjës te **Parkut Udhëtareve**, ne kundërshtim me piken 1/b te VKM nr. 472, date 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit te fondeve buxhetore”, konkretisht: Irena Kashanjori 5,000 leke, Q.K. 10,000 leke, D.K. 10,000 leke.

Brenda muajit Tetor 2014

10. Vlera 1,919,473 lekë, për 8 subjekte *shpk* , për *punime të pakryera*, pasi ka diferenca mes situacionit dhe punimeve në fakt, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i trete, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, konkretisht:

1-vlera 9,792 lekë, për *shpk* “B...”, për punime të pakryera në objektin: “Riveshja asfaltime ne rrugën Antipatrea (segmenti Karburant Hasani-Ura e vjetër Gorice).

2-vlera 266,088 lekë, për *shpk* “B...Company”, për punime të pakryera në objektin: “Rikonstruksion i shkollës Shyqiri Lakra”.

3-vlera 221,760 lekë, për *shpk* “L...Konstruksion” për punime të pakryera në objektin: “Rikonstruksion i trotuarit ne rrugen Antipatrea, segmenti ish-divizioni-ura Uznov Berat”. 4-

vlera 151,980 lekë, për shpk "B...Company" për punime të pakryera në objektin: "Sistemim, Asfaltim Rruga Axhensi Th. Tani (Suelas)" Berat.

5-vlera 39,954 lekë, për R.K. dhe V.Z. për rritje të pajustificuar të fondit limit në objektin: "Rikonstruksioni i Fushës së Stadiumit Tomori (Ndërtim rezervuari për impiantin vaditës të fushës së stadiumit)"

6-vlera 85,440 lekë, për shpk "S..." për punime të pakryera në objektin: "Rikonstruksioni i Fushës së Stadiumit Tomori (Drenazhimi)" Berat.

7-vlera 983,327 lekë, për "A...Konstruksion" për punime të pakryera në objektin: Rikonstruksion i Stadiumit Tomori " Berat.

8-vlera 161,132 lekë, për shpk "A...&A...Construction" për punime të pakryera në objektin: "Sistemim i hapësirave urbane në lagjen Çlirim pranë Shkollës Mehmet Ali Vrioni".

Brenda muajit Tetor 2014

11. Vlera 4,285,111 lekë sa përfituar padrejtësisht nga **7 anëtarë të Këshillit Bashkiak**, në kundërshtim me ligjin nr. 8652 datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 25 pika a,b,c, ç dhe ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" neni 4 pika d, duke qenë në marrëdhënie pune në njësitë vartëse të Bashkisë në papajtueshmëri të funksionit të këshilltarit dhe në kushtet e konfliktit të interesit, përkatësisht: M.H. 298,812 lekë, F.Ç. 271,860 lekë, A.B. 1,783,345 lekë, F.K. 271,860 lekë, L.M.146,568 lekë, T.K. 208,032 lekë dhe V.Z. 1,304,634 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2014

12. Vlera 480,036 lekë, përfituar **pagë më tepër** nga **4 punonjës**, në kundërshtim me pikën 1/c lidhjen nr. 2 të VKM nr. 693 datë 18.8.2010, me VKM nr. 553, datë 11.8.2011 dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe 586, datë 17.07.2013 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", përkatësisht R.N. 158,354 lekë, M.V. 51,819 lekë, M.K. 97,054 lekë dhe A.K. 172,809 lekë.

Brenda muajit Tetor 2014

13. Vlera 33,983 lekë, për 17 punonjëse të administratës së Bashkisë, për **shpenzimin e paligjshme** për dreke me rastin e festës 8 Marsit, në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" pika 9 të ndryshuar me VKM nr. 826, datë 05.12.2011 dhe me VKM nr. 849, datë 06.12.2012, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur Raportit të auditimit.

Brenda muajit Tetor 2014

14. vlera 8,539,922 lekë, për "**I...Constructructions**" shpk, sipërmarrës i shërbimit të pastrimit të qytetit, duke bërë përlllogaritjet **për pagesë te tepërt në situacionet e pastrimit** për periudhën 3-vjeçare 2011-2013, pasi janë përfshirë zërat "Mirëmbajtja e pikave dhe grumbullimi i mbetjeve inerte skeletike" dhe "Larja speciale e rrugëve", në kundërshtim me ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave" Kreun II-të, neni 5 "Mbeturinat" dhe Kreun III-të, neni 18 "Lagia e zonave të pastrimit", si dhe për çmime të llogaritura gabim në 8 zëra punimesh, pasi është bërë llogaritja e përqindjes të fitimit të planifikuar edhe mbi shpenzimet administrative (shpenzimet e përgjithshme), në kundërshtim me Udhëzimin KM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu II, shkronja "B".

Brenda muajit Dhjetor 2014

15. Vlera 71,842 lekë, për këshilltarët Ç.B. 37,650 lekë dhe V.Z. 34,192 lekë, për pagesa të paligjshme në udhëtim e dieta jashtë vendit, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" pika 1.

Brenda muajit Dhjetor 2014

16. Vlera 280,146 lekë, për shpenzime te paligjshme, tejkalim kufirit ligjor te kuotave te përcaktuara si koktej, dreka dhe dhurata në aktiviteteteve të ndryshme, në kundërshtim me pikën 1/c dhe 9 të VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999, për organizatorët dhe komisionit të blerjeve me vlera të vogla, përkatësisht: A.P. 46,691 leke, K.K. 46,691 leke, G. Z. 46,691 leke, L.B. 46,691 lekë, D.D. 46,691 lekë dhe A.R. 46,691 lekë.

Brenda muajit Shtator 2014

17. Vlera 1,696,734 leke, për llogaritje gabim të taksës së ndikimit në infrastrukture dhe taksës për lejet e shfrytëzimit, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, date 17.09.1998 “Për Urbanistiken” ndryshuar, përkatësisht nga 6 subjektet: “F...” shpk 1,066,650 lekë, “Sh...” shpk 607,970 lekë, I.Gj. 304 leke, A.G. 7,500 lekë, Xh.S. 11,810 lekë, D.A. 2,500 lekë.

Brenda muajit Nentor 2014

18. Vlera 26,486,000 lekë, detyrim i pa dokumentuar në kontabilitet, mungese te ardhurash sipas kushteve kontraktive, nga moszbatimi i Akt Marrëveshjes datë 15.04.201 midis Bashkisë Berat dhe Sha Ujësjiellës Kanalizime Berat (në cilësinë e agjentit tatimorë), për arkëtimin e taksës pastrimit, gjelbërimit, tokës bujqësore, ndërtesës dhe ndriçimit, kontratë e pa realizuar për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Brenda muajit Shtator 2014

19. Vlera 3,364,740 lekë, detyrim i pa kontabilizuar, rezultuar nga kontrata enfiteozë nr. prot. 237, datë 20.3.2013, ndërmjet Bashkisë Berat në cilësinë e enfiteozë dhënësit dhe subjektit “B...” e përfaqësuar nga administratori P.T. në cilësinë e enfiteozëmarrësit, ku për vitin 2013 ka një detyrim kontraktgjë në vlerën 3,364,740 lekë, të pa likuiduar, duke bërë rivlerësimin të zbatimit të kushteve të kontratës dhe rilllogaritjen e detyrimit përkatës.

Brenda muajit Shtator 2014

20. Vlera 239,084 leke, detyrime të pa regjistruara në kontabilitet, për kontratat e qirave të pa zbatuara të vitit 2012 nga 9 subjekte me një detyrim për 149,555 lekë dhe për vitin 2013 nga 9 subjekte me një detyrim me 89,429 lekë.

Brenda muajit Shtator 2014.

21. Vlera 541,200 lekë, diference e pa llogaritur dhe e pa paguar e taksës së ndërtesës që i përket subjektit M.A. me nr. identifikimi L12804003P, për ushtrim aktiviteti “Tregti me pakicë të materialeve të ndërtimit gomisteri dhe lavazho etj”, për sa është llogaritur më pak sipërfaqja e ndërtimit për 1804 m2, sipas plan vendosjes së objektit, dhe nga përlllogaritjet rezulton detyrim për vitet 2012 e 2013, në shumën 541,200 lekë. Të mbartet si detyrim në kontabilitet dhe të arkëtohet.

Brenda muajit Dhjetor 2014

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, bazuar në Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, i rekomandojmë Komisionit të dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:
- Heqjen e Licencës, për një afat prej 1-2 vjet, për 2 mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit dhe 2 kolaudatoreve, respektivisht:

1. z. Q.Gj., mbikëqyrës i punimeve me licence nr. MK 0275, lidhur kontrate date 23.5.2011,
2. zj. L.B., kolaudatore e punimeve me licence nr. MK 0310/2, lidhur kontrate date 7.12.2011,
Për arsyet e mëposhtme:

-Objekti **“Rikonstruksion i Stadiumit Tomori Berat”** është kryer sipas kontratës për punë publike në datë 23.05.2011, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, përfaqësuar nga kryetari z.Fadil Nasufi dhe operatorit ekonomik “A...Konstruksion” Sh.p.k përfaqësuar nga z.Xhavit Ismaili, administrator i shoqërisë, me vlerë të kontratës 26,453,812 lekë me T.V.SH, me afat zbatimi kontrate 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e lidhjes së kontratës.

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas urdhrit datë 23.05.2011 dhe sipas kontratës të kësaj date është caktuar inxh. Q.Gj. me nr. liçencë MK.0275 me pagesë per 430,500 lekë.

Për kolaudimin e punimeve të objektit të përfunduar sipas urdhrit datë 07.12.2011 dhe sipas kontratës të po kësaj date është caktuar është ing. L.B. me nr. licencë MK.0310/2.

Në datë 12.12.2011 është nënshkruar Certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve.

I. Nga verifikimi në terren i punimeve të kryera në objektin “Stadiumi Tomorri”, rezulton tejet i amortizuar për një periudhe gati dy vjeçare që prej marrjes në dorëzim. Konkretisht paraqiten problemet si më poshtë:

-Suvatimi i soletës së tribunës nuk është kryer sipas projekt-preventivit të miratuar, **“suvatim solete”** por rezulton i suvatuar sipas zërit, **“suvatim fasade me granil”** çka sjellë ndryshime në cilësi dhe në çmim të pasqyruara si më poshtë;

-Stolat e vendosur në tribunë, rezultojnë të jenë të situacionuara tepër 168 copë;

-Shkallët e tribunës, shkeljet, rezultojnë të palyera me mastiç 2.5 mm për hidroizolim dhe në vendet ku është realizuar ky volum pune, lyerja është shumë e dobët, jo me dy duar për të arritur trashësinë 2.5 mm dhe jo uniforme çka ka sjellë edhe problemet e lagështisë të përmendura më poshtë;

-Në shkallët e tribunës *shtresa 4cm beton* rezulton e kryer jo në mënyrë jo uniforme dhe në disa vende e pakryer;

-Në ambiente të ndryshme ka probleme lagështie në muret anësore dhe ato tavanore çka ka sjellë edhe prishjen e suvatimeve e bojatisjes si dhe amortizimin e tyre të shpejtë;

-Pajisjet hidrosanitare si WC, lavamanë etj, në shumë raste janë të dala jashtë përdorimit për shkak edhe të keqpërdorimit por *mbi të gjitha prej cilësisë së dobët të punimeve të kryera*;

-Dyert e brendshme të drurit me kasë dërrase tambur kompensate në disa ambiente janë krejtësisht të çmontuar dhe amortizuara kjo për shkak edhe të keqpërdorimit por *mbi të gjitha prej cilësisë së dobët të punimeve të kryera*;

-Punimet e duraluminit janë të papërfunduara. Ato rezultojnë të pa silikonuara jashtë dhe brenda, në shumë vende shkuma mbushëse është ende e pa prerë dhe pa u silikonuar;

-Rrjeti elektrik në disa ambiente nuk është maskuar nën suva siç e parashikon projekt-preventivi por është lënë i varur në muret e korridoreve;

Sa sipër, ***tregon për një cilësi shumë të dobët të punimeve dhe papërgjegjshmëri në mbikëqyrjen punimeve, në kolaudimin e objektit si dhe në marrjen në dorëzim të këtyre punimeve.*** Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7971 “Për prokurimin publik” me ndryshimet përkatëse të Udhëzimit Nr. 1 datë 01.01.1996, me Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I pika 1 dhe Kreu II pika 3 dhe ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi dhe kolaudatori.

II. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezulton se ka mungesë dokumentacioni si më poshtë.

-Mungon miratimi i shtyrjes së afatit të punimeve nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Berat. Kjo është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 36, pika 1 “...Çdo

amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.”

-Projekti fillestar, i ndryshuar me kërkesë të mbikëqyrësit, nuk rezulton i miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Berat. Punimet në objekt janë kryer sipas këtij projekti **edhe pse i pa miratuar**;

-Dosja e zbatimit përmban vetëm një proces verbal të punimeve të maskuara për tre zëra dhe për proceset e tjera të punës të cilësuar si të maskuara nuk janë mbajtur proces-verbale;
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve.

III. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezultojnë pune të pakryera në vlerën 983,327 lekë me T.V.SH dëm ekonomik (819,439 x 1.2=983,327 lekë).

Mbikëqyrësi i punimeve, ka nënshkruar situacionet për **punime të pakryera**, për pasojë i është shkaktuar buxhetit të shtetit një **dëm ekonomik** në vlerën **983,327 lekë me tvsh.**

Sa sipër, veprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 7971 “Për prokurimin publik” me ndryshimet përkatëse të Udhëzimit Nr. 1 datë 01.01.1996, me paragrafin e tretë të nenit 7 dhe me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin Q.Gj. dhe kolaudatoren L.B.

Për,

2. z. L.N., mbikëqyrës i punimeve me licence nr. 0230/1, lidhur kontrate date 2.5.2012,

3. zj. A.K., kolaudatore e punimeve me licence nr. MK.0685, lidhur kontrate date 22.8.2012,

Për arsyet e mëposhtme:

-Mbi auditimin e ushtruar në dokumentacionin teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit në objektin: **“Rikonstruktion i trotuarit në rrugën Antipatrea, segmenti ish-divizioni-ura Uznov Berat”**. Rikonstrukcioni i trotuarit në rrugën Antipatrea, segmenti ish-divizioni-ura Uznov Berat” është kryer sipas kontratës për punë publike, datë 02.05.2012, lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, përfaqësuar nga Kryetari dhe Operatorit Ekonomik “L...K...” sh.p.k përfaqësuar nga z. F.Sh., me vlerë të kontratës 13,282,187 lekë me t.v.sh , me afat 60 dite nga data e lidhjes së kontratës. Përdorimi i fondit rezervë është bere për vlerën 260,382 lekë me t.v.sh Me datën 30.6.2012 është mbajtur proces-verbal në prani të sipërmarrësit të punimeve përfaqësuar nga Ing. F.Sh., mbikëqyrësi i punimeve L.N., përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor R.K. dhe T.H., për efekt të miratimit të ndryshimeve në volume.

-Për ndjekjen e zbatimit të kontratës është caktuar me datë 2.5.2012 ing. L.N., me detyrë mbikëqyrës i punimeve sipas kontratës për punë publike datë 02.05.2012. Nga auditimi dhe verifikimi në terren, rezultuan këto probleme:

-Mungon libri i instruktimit teknik.

-Nga krahasimi i volumeve të preventivit te miratuar, situacionit dhe librezës së masave dhe punimeve faktike në vend, u konstatuan diferenca në **punime të pakryera** në 3 zëra me vlerën **221,760 lekë dëm ekonomik me TVSH (184,800 x 1,2 =221,760).**

-Nga verifikimi në vend rezulton se **punimet për Rikonstrukcionin e trotuarit nuk janë cilësore, pasi në disa vende trotuari ka disnivele, pllaka të dala, shtylla të pa spostuara** duke i lënë në mes trotuarit ose në cep të tij.

Veprime në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve L.N., si dhe kolaudatoren A.K. sipas akt kolaudimit dhe kontratës datë 22.08.2012, e cila ka kolauduar objektin me diferenca në volume për 3 zëra.

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, në VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “*Për disiplinën në shërbimin civil*”, si dhe kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, **kërkojmë** nga Kryetari i Bashkisë, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

“Largim nga detyra”, për:

1. L.B. me detyrë **Drejtoreshe e financës dhe në cilësinë e anëtares se KVO** si dhe në **cilësinë e nëpunësit zbatues**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e disa pagesave të paligjshme për vitin 2011, 2012 dhe 2013, çka ka krijuar një dem ekonomik për buxhetin e bashkisë për vlerën 30 milion leke.

-Për favorizimin në kualifikimin dhe shpalljen fitues në 2 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues ShPK “B...” në tenderin “*Riveshje e shtresës asfaltim rruga Antipatrea segmenti Karburant Hasani-Ura e vjetër Gorrice*” dhe ShPK “B... Company”, në tenderin “*Sistemim, asfaltim rruga Axhensi –Th.Tani (Suelas) Berat, viti 2011*”, në kushtet kur 2 subjektet rezultojnë debitorë pranë Bashkisë dhe kanë mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit në tender, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, Kreu VII, “*Kushte të përgjithshme për zbatim*”, pika 1, “*Mungesa e konkurrencës*”, germa “a”.

-Për mos ndalesën dhe mos kontabilizimin e detyrimeve debitorë për vlerën 764,597 lekë për ShPK “*Beqiri*” dhe vlerën 457,969 lekë për ShPK “*B...Company*”, për punime të pakryera, sipas shkresës nr. 652/12, datë 28.07.2011, akt verifikimit datë 19.11.2010 të KLSH-se.

-Për pagesat e kryera për shërbime në 3 raste në vlerën 313,700 lekë, pa zhvilluar procedurën e prokurimit me vlera të vogla, në kundërshtim me Kreu i VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” të ndryshuar dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*”.

- Për pagesat e paligjshme për shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit për këshilltarë, në 2 raste në vlerën 71,842 lekë dem ekonomik, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*” pika 1.

-Për lejimin e pagesave në 3 raste për shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit, pa marrë konfirmimin e Ministrit të Brendshëm, në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr. 589, datë 5.09.2012 “*Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore*”.

-Për pagesën e kryer në vlerën 171,000 lekë për një udhëtim turistik në kuadër të projektit të Bashkisë Bera “*Fondi i ekselencës për nxënësit e talentuar*”, në kundërshtim me pikën 115/a “*shpenzimet për funksionet e përbashkëta*” të Kreut II. 3 “*Buxheti vendor*” të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”.

-Për pagesat të paligjshme për vlerën 280,146 lekë, për shtrim koktejesh dhe drekash si dhe blerje dhuratash në kuadër të organizimeve të aktiviteteve të ndryshme, ku janë tejkaluar kuotat e përcaktuara për këto lloj shpenzimesh, në kundërshtim me pikën 1/c dhe 9 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja*” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 pasqyra 3.

2. R.K., me detyrë **Drejtor Planifikimit dhe Territorit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për shkelje në procedurat e dhënies së lejeve të shesheve e lejeve të ndërtimit si dhe lejeve të shfrytëzimit.

-Për mos respektimin e afateve dhe mos miratimin në KRT të lejeve të shfrytëzimit.

-Për dhënien e lejeve të shfrytëzimit me akt kolaudim të pa nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve, pa dokumentacionin e përfundimit të punimeve të infrastrukturës inxhinjerike.

-Për mos aplikimin e sakte dhe mos arkëtimin e taksës ndikimit infrastrukturës për 2 subjekte, çka ka shkaktuar vlerën gjithsej 1,674,620 lekë dem ekonomik.

Veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit të Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998 i ndryshuar, me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ” *Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, datë 15.03.2001.

-Për favorizimin në kualifikimin dhe shpalljen fitues në 2 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues *ShPK “B..”* në tenderin *“Riveshje e shtresës asfaltim rruga Antipatrea segmenti Karburant Hasani-Ura e vjetër Gorrice”* dhe *ShPK “B..Company”*, në tenderin *“Sistemim, asfaltim rruga Axhensi –Th.Tani (Suelas) Berat*, në kushtet kur 2 subjektet rezultojnë debitorë pranë Bashkisë dhe kanë mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit në tender, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, *“Mungesa e konkurrencës”*, germa *“a”*.

-Për shkelje në marrjen në dorëzim të disa objekteve investimesh, për punime të pakryera dhe mangësi në drejtim të zbatimit të projekteve të miratuara, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, datë 15.03.2001.

3. V.Z., me detyrë *sekretare e sekretarisë teknike dhe arshivës* në Drejtorinë Planifikimit dhe Territorit dhe **në cilësinë e anëtarit të KVO**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për sa llogaritur gabim taksën e ndikimit në infrastrukturë për 6 subjekte në vlerën prej 1,696,734 lekë dem ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e ligjit të Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998 i ndryshuar.

-Për shkelje në marrjen në dorëzim të disa objekteve investimesh, për punime të pakryera dhe mangësi në drejtim të hartimit të projekteve dhe preventivave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, datë 15.03.2001.

-Për favorizimin në kualifikimin dhe shpalljen fitues në 2 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues *ShPK “B..”* në tenderin *“Riveshje e shtresës asfaltim rruga Antipatrea segmenti Karburant Hasani-Ura e vjetër Gorrice”* dhe *ShPK “B..Company”*, në tenderin *“Sistemim, asfaltim rruga Axhensi –Th.Tani (Suelas) Berat , viti 2011*, në kushtet kur 2 subjektet rezultojnë debitorë pranë Bashkisë dhe kanë mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit në tender, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, *“Mungesa e konkurrencës”*, germa *“a”*.

4. M.S., me detyrë, **Drejtor e Drejtorisë Menaxhimit** të Banesave Sociale me Qira, Strehimit dhe Pronave” dhe **në cilësinë e anëtarit të KVO**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për krijimin e deficitit në të ardhurat e kontraktuara në vlerën 3,364,740 lekë mungese të ardhurash, për merkaton sipas kontratës nr. port. 237, datë 20 .3. 2013 e lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe subjektit *“B..Trade”* e përfaqësuar nga administratori P.T. në cilësinë e enfitozëmarrësit, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 *“Për përcaktimin e kriterëve , të procedurës dhe mënyrës së dhënies më qira ,efiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”* kapitulli nr. 6,” Monitorimi i kontratave”, pika nr. 2 a, dhe me rregulloren brendshme të bashkisë neni 7.

-Për favorizimin në kualifikimin dhe shpalljen fitues në 2 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues *ShPK “B..”* në tenderin *“Riveshje e shtresës asfaltim rruga Antipatrea*

segmenti Karburant Hasani-Ura e vjetër Gorrice” dhe ShPK “Bl...Company”, ne tenderin “Sistemim, asfaltim rruga Axhensi –Th.Tani (Suelas) Berat, viti 2011, ne kushtet kur 2 subjektet rezultojnë debitorë pranë Bashkisë dhe kane mangësi ne dokumentacion, ne kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit ne tender, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

“Zbritje nga detyra per nje periudhe 1 vjecare”

5. E.P., me detyrë N/kryetare e Bashkise dhe në cilësinë e kryetares se KVO si dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues, për shkeljet e mëposhtme:

-Për favorizimin ne kualifikimin dhe shpalljen fitues ne 2 raste, përkatësisht për operatorin ekonomik fitues ShPK “B...” ne tenderin “Riveshje e shtresës asfaltime rruga Antipatrea segmenti Karburant Hasani-Ura e vjetër Gorrice” dhe ShPK “B...Company”, ne tenderin “Sistemim, asfaltim rruga Axhensi –Th.Tani (Suelas) Berat , viti 2011, ne kushtet kur 2 subjektet rezultojnë debitorë pranë Bashkisë dhe kane mangësi ne dokumentacion, ne kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit ne tender, me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

-Për mos ndalesën e detyrimeve debitorë për vlerën 764,597 lekë për ShPK “B...” dhe vlerën 457,969 lekë për ShPK “B...Company“, për punime te pakryera, sipas shkresës nr. 652/12, date 28.07.2011, akt verifikimit date 19.11.2010 te KLSH-se.

-Për mos zhvillim te procedurës se prokurimit me vlera të vogla për shërbime në 3 raste në vlerën 313,700 lekë, në kundërshtim me Kreu i VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe me Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 “Për procedurën prokurimit vlera vogla”.

-Për pagesat te parregullta në 3 raste për shpenzime udhëtim e dieta jashtë vendit, pa marrë konfirmimin e Ministrit të Brendshëm , në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr. 589, datë 5.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.

-Për shpenzime te paligjshme në vlerën 280,146 lekë, për koktej, dreka dhe blerje dhurata në kuadër të organizimeve të aktiviteteve të ndryshme, pasi janë tejkaluar kuotat ligjore, në kundërshtim me pikën 1/c dhe 9 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 pasqyra 3.

6. B.B., me detyrë Drejtor i taksave dhe tarifave vendore dhe tregjeve, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizim të taksave e tarifave vendore për periudhën 2011- 2013, në vlerën 135,057 mijë lekë.

-Për mos zbatim të procedurave ligjore, lidhur me rakordimin me Drejtorinë Rajonale të Tatimore Berat për biznesin e madh, me Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor për taksën e regjistrimit automjeteve dhe ZVRPP Berat, etj. të përcaktuara në nenit 7 dhe 61, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Procedurat Tatimore”, udhëzimit të MF nr. 24, datë 02/09/2008 në zbatim të ligjit “Procedurat Tatimore” me ndryshime.

-Për moskrijimin e regjistrimit për abonentët familjarë, për taksën tokës bujqësore, ndërtesës, pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime.

-Për mungesën e kontrollit dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për moszbatimin e kontratës nga agjenti Tatimorë “Ndërmarrja e Ujësjellës- Kanalizime Sh.a.Berat”, ku për 3 vjet është krijuar

difiçit në të ardhurat e programuara nga taksa e pasurisë, taksa e tokës bujqësore, tarifa e pastrimit, tarifa e gjelbërimit dhe tarifa e ndriçimit publik në vlerën 26,486 mijë lekë, veprime në kundërshtim Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

7. E.K., me detyrë **ish-Drejtor i Urbanistikës Bashkia Berat**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për shkelje në procedurat e dhënies së lejeve të shesheve e lejeve të ndërtimit si dhe lejeve të shfrytëzimit.

-Për mos respektimin e afateve dhe mos miratimin në KRT të lejeve të shfrytëzimit.

-Për dhënien e lejeve të shfrytëzimit me akt kolaudim te pa nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve, pa dokumentacionin e përfundimit te punimeve të infrastrukturës inxhinjrike etj.

-Për mos aplikimin e sakte dhe mos arkëtimin e taksës ndikimit infrastrukturës per 2 subjekte, çka ka shkaktuar vlerën gjithsej 1,674,620 lekë dem ekonomik.

Veprime ne kundërshtim me kërkesat e ligjit të Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998 i ndryshuar, me ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 i ndryshuar dhe me udhëzimin nr. 3, date 15.03.2001.

-Për disa mangësi ne dokumentacionin e tenderimeve, ne cilësinë e antarit te njësisë se prokurimit, ne kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

“Vrejtje me paralajmërim”

8. G.Z., me detyrë **ish-Drejtores e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore** dhe në cilësinë e menaxhueses së dosjeve të personelit (*periudha 01.01.2011-12.02.2013*), për shkeljet e mëposhtme:

-për hartimin e shkresave të emërimit dhe përcaktimit të gabuar të klasifikimit të pagave për 4 punonjës i cili nuk përputhet me arsimimin e tyre, duke përfituar më tepër pagesa në shumën 480,036 lekë, në kundërshtim me pikën 1/c lidhjen nr. 2 të VKM nr. 693, datë 18.8.2010, me VKM nr. 553, datë 11.8.2011 dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

9.T.M., me detyrë **Drejtores e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore** (*periudha 12.02.2012 e në vazhdim*), për shkeljet e mëposhtme:

-Për mosplotësim të dosjeve për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm për mbështetjen e klasifikimit të pagave të punonjësve dhe lejimin në vazhdimësi të pagesës për 4 punonjës jo në përputhje me arsimimin e tyre, duke përfituar më tepër pagesa në shumën 480,036 lekë, në kundërshtim me pikën 1/c lidhjen nr. 2 të VKM nr. 693, datë 18.8.2010, me VKM nr. 553, datë 11.8.2011 dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

-Për miratimin dhe pagesat e bëra në shumën 480,036 lekë për paga për 4 punonjës, në kundërshtim me pikën 1/c lidhjen nr. 2 të VKM nr. 693, datë 18.8.2010, me VKM nr. 553, datë 11.8.2011 dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

10. V.S. me detyrë **Drejtor i Kulturës Rinisë**, per shkeljet e mëposhtme:

-Për hartimin dhe realizimin e udhëtimit turistik në kuadër të projektit të Bashkisë Berat “Fondi i ekselencës për nxënësit e talentuar” në vlerën 171,000 lekë, në kundërshtim me pikën 115/a “shpenzimet për funksionet e përbashkëta” të Kreut II.3. “Buxheti vendor” UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

11. M.K., me detyrë **juriste**, ne cilësinë e kryetares se njësisë prokurimit, për disa te meta dhe mangësi ne dokumentacionin e tenderimeve, ne kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 144 dhe 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, **kërkojmë** që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, kryetari i Bashkisë Berat të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

“Zgjidhje e menjëhershme e Kontratë së Punës” sipas nenit 153 të Kodit të Punës.

A. për punonjësit e INUV:

12. E.C., me detyrë **ish-K/Inspektor të INUV** gjatë viteve 2011-2012,

13. L.T., me detyrë **ish-K/Inspektor të INUV** gjatë viteve 2011-2012,

14. S.K., me detyrë **K/Inspektor INUV** nga data 15.07.2013 e vazhdim,

Për arsye të mëposhtme:

-Për paaftësi ne kryerjen e detyrës dhe mungese profesionalizmi pasi mbulojnë detyrën e k/inspektorit te INUV pa arsimin përkatës profesional ne fushën e inxhinierisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” neni 11”, mbasi asnjë nga punonjësit e emëruar nuk plotëson kushtet e mësipërme, konkretisht *E.C., me detyrë ish-Kryeinspektor i INUV Berat për periudhën 10.01.2011 deri 02.11.2011, L.T., me detyrë ish-Kryeinspektor i INUV Berat për periudhën 02.11.2011 deri 15.07.2013 dhe Saimir Kazazi, me detyrë aktualisht Kryeinspektor i INUV Berat për periudhën nga data 15.07.2013 e vazhdim.*

-Për mos zbatimin e ligjshmërisë dhe standarteve teknike në fushën e ndërtimit,

-Për lejimin e ndertimit ne objektin: *Shtese dyqani kati i dyte dhe dalje brenda oborrit te shkolles 9-vjecare “Shyqyri Lakra” e shoqeruar me shkalle betoni sipas proces-verbalit date 27.5.2013 nga inspektoret L.T., I.L.j dhe A.J., për mosvendosje gjobë dhe mosmarrje vendim prishje për këtë ndërtim pa leje shtesë jashtë zonës mbrojtur,*

-Për mos vënie në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në lidhje me 3 objektet pa leje dhe te ndertuara ne zonen e mbrojtur, perkatesisht:

1.objekti 2 kat (*vilë*, pranë Xhamisë tek agjensia,

2.objekti 3 kat dhe kati 3 shtesë ndërtuar gjatë vitit 2013-2014,

3.objekti 1 kat ndërtuar në lulishte pranë BKT,

-Për mos zbatim të sanksioneve si, gjoba, prishje dhe kallxim penal per 3 objektet pa leje te ndertuara ne zonen e mbrojtur.

Veprime në kundërshtim me nenin 75 të ligjit 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar, me nenin 5 të ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektoriatin e Ndërtimit”, me nenin 15/a, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998” *Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të ndërtimit*”, kreu III-të ”Sanksionet” ndryshuar me ligjin nr. 9794, datë 23.07.2007 etj, me nenin 81 “Sanksionet” të ligjit të Urbanistikës dhe pikës 8 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për

unifikimin e procedurave të Kontrollit të teritorit nga Inspektoriati ndërtimor e Urbanistik kombëtar e Vendor”.

B. për punonjësit e Parkut Udhëtareve Berat:

15. S.M., me detyrë **Drejtor i Parkut Udhëtareve Berat,** njësi vartëse e bashkise:

Për arsyet e mëposhtme:

-Për paaftësi menaxhimi të Parkut Udhëtareve Berat.

-Për lejimin dhe mos zgjidhjen e gjendjes negative financiare te Parkut Udhëtareve për vitin 2011,2012 dhe 2013, i cili ndodhet ne kushtet e plota te falimentimit, pasi shoqërohet me humbje te njëpasnjëshme për 3 vite radhazi dhe paraqet një borxh publik për vlerën 7 milion leke.

-për mos administrim shpenzimeve karburantit si zë me peshe ndaj shpenzimeve,

-për mos hartimin dhe aplikimin për çdo vit te normativave te harxhimit te karburantit për 100 km për 13 autobuzat, bazuar ne librezat e çdo mjete dhe ne aktverifikimet ne vend me komision specialiste te fushës, por është njaftuar me disa norma te vitit 2011 te mbartura nga vitet e kaluara, qe variojne me normativa te larta nga 42-47 litra/100 km për mjet.

-për mos reduktimin e 13 autobusëve duke bërë bllokimin e disa autobuzave jo rentabël,

- për mos reduktimin e shpenzimeve për paga dhe mos reduktimin e organikes se Parkut,

-për mos marrjen e masave për rritjen e te ardhurave,

-Për mos çregjistrimin e 3 autobuzave te amortizuar pranë DRSHTRR Berat, ne kundërshtim me ligjin nr. 8378, date 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i RSH*”,

Veprime ne kundërshtim me nenin 2, 5/1, 8 etj të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin*”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik*”, me nenin nr. 1 te *Rregullores Brendshme Bashkise*, me nenin 13 dhe 14/1 te ligjit nr. 8901, date 23.5.2002 i ndryshuar me ligjin nr. 9919, date 19.5.2008 dhe nr. 10,137, date 11.5.2009 “*Për ndërmarrjet ne falimentim*”, me nenin 31 te ligjit nr. 7582, date 13.7.1992 “*Për ndërmarrjet shtetërore*”.

-Për lejimin e pagesës paligjshme për këshillin drejtues, pasi është përfituar padrejtësisht rritja e indeksimit te pagës se ulet, ne kushtet me humbje financiare për vitin 2011, 2012 dhe 2013, duke krijuar një dëm ekonomik për vlerën 942,000 lekë, ne kundërshtim me piken 3 te VKM nr. 317, date 8.7.1999 “*Për shpërblimin e punës se punonjësve*”, me piken 4 te VKM nr. 317, date 8.7.1999 “*Për shpërblimin e punës se punonjësve*”, me VKM nr. 566, date 14.7.2010, nr. 527, date 20.7.2011 dhe nr. 573, date 3.7.2013 “*Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi*”, me nenin 19/4, me nenin 23/3 te ligjit nr. 7582, date 13.7.1992 “*Për ndërmarrjet shtetërore*”.

16. R.Gj. me detyrë **K/D/Financës te Parkut Udhëtareve Berat,** njësi vartëse e bashkise:

Për arsyet e mëposhtme:

-Për lejimin e pagesës paligjshme për këshillin drejtues, pasi është përfituar padrejtësisht rritja e indeksimit te pagës se ulet, ne kushtet me humbje financiare për vitin 2011, 2012 dhe 2013, duke krijuar një dëm ekonomik për vlerën 942,000 lekë, ne kundërshtim me piken 3 te VKM nr. 317, date 8.7.1999 “*Për shpërblimin e punës se punonjësve*”, me piken 4 te VKM nr. 317, date 8.7.1999 “*Për shpërblimin e punës se punonjësve*”, me VKM nr. 566, date 14.7.2010, nr. 527, date 20.7.2011 dhe nr. 573, date 3.7.2013 “*Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi*”, me nenin 19/4, me nenin 23/3 te ligjit nr. 7582, date 13.7.1992 “*Për ndërmarrjet shtetërore*”,

-për lejimin e rezultatit me humbje financiare te njëpasnjëshme për vitin 2011,2012 dhe 2013,

-Për mos administrim te shpenzimeve te karburantit si zë me peshe kryesore ndaj shpenzimeve. Për mos hartimin dhe aplikimin çdo vit te normativave te harxhimit te karburantit për 100 km për 13 autobuzat, bazuar ne librezat e çdo mjete dhe ne aktverifikimet ne vend me komision specialiste te fushës,

- për mos marrjen e masave për rritjen e te ardhurave si dhe kontrollit e administrimit te rrepte te tyre,

- për lejimin e krijimit të borxhit publik për vlerën 7,381,090 leke për detyrime fiskale dhe sigurime shoqërore,

Veprime në kundërshtim me nenin 2, 5/1, 8 etj të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik”, me nenin nr. 1 të Rregullores Brendshme Bashkise, me nenin 13 dhe 14/1 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008 dhe nr. 10,137, datë 11.5.2009 “Për ndërmarrjet në falimentim”, me nenin 31 të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” .

“Vrejtje paralajmëruese”

17. R.K., me detyrë **ekonomist i Parkut Udhëtarëve Berat**, njësi vartëse e bashkise:

Për arsyt e mëposhtme:

-Për aplikimin e pagesave të paligjshme për këshillin drejtues, pasi është përlogaritur dhe përfituar padrejtësisht rritja e indeksimit të pagës së ulet, në kushtet me humbje financiare për vitin 2011, 2012 dhe 2013, duke krijuar një dëm ekonomik për vlerën 942,000 lekë, në kundërshtim me piken 3 të VKM nr. 317, datë 8.7.1999 “Për shpërblimin e punës së punonjësve”, me piken 4 të VKM nr. 317, datë 8.7.1999 “Për shpërblimin e punës së punonjësve”, me VKM nr. 566, datë 14.7.2010, nr. 527, datë 20.7.2011 dhe nr. 573, datë 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me nenin 19/4, me nenin 23/3 të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”,

- Për mos planifikimin çdo vit të normativave të harxhimit të karburantit për 100 km për 13 autobuzat, bazuar në librezat e çdo mjete dhe në aktverifikimet në vend me komision specialiste të fushës, por është mjaftuar me disa norma të vitit 2011 të mbartura nga vitet e kaluara, që variojnë me normativa të larta nga 42-47 litra/100 km për mjet.

- për mos planifikimin e sakte të të ardhurave si dhe mungesë të administrimit të tyre,

Veprime në kundërshtim me nenin 2, 5/1, 8 etj të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxh. Finan. dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik”, me nenin nr. 1 të Rregullores Brendshme Bashkise, me nenin 13 dhe 14/1 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008 dhe nr. 10,137, datë 11.5.2009 “Për ndërmarrjet në falimentim”, me nenin 31 të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” .

18. P.K., me detyrë **administrator i KF Tomori shoqëri aksionare**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për përcaktimin e gabuar të pagave të disa futbollistëve e trajnerëve të KF, në kontratat përkatëse, pa mbështetje ligjore, në kushtet e gjendjes së vështirë financiare dhe mungesës së ardhurave të veta si dhe mblimit të shpenzimeve për paga nga buxheti i bashkise, për 3-mujorin e IV të vitit 2011, për vitin 2012 dhe 2013 janë aplikuar paga të larta, çka ka shkaktuar një efekt financiar për vlerën 5,835,420 leke dëm ekonomik, në kundërshtim me nenin 15 dhe 19 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve qeverisjes vendore”, me VKM nr. 566, datë 14.7.2010, nr. 527, datë 20.7.2011 dhe nr. 573, datë 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me nenin 97 dhe 160 “shpërblimi” etj të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët e shoqëritë tregtare”, me nenin 18 “shoqëritë sportive” dhe nenin 36 kreu XI “Burimet e financimit” etj të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për Sportin” i ndryshuar me ligjin nr. 9816, datë 22.10.2007, me nenin 2 “Qëllimi i krijimit shoqërisë” dhe nenin 6 “Objekti” etj të Akt Themelimit të Shoqërisë Aksionare ‘FK Tomori 1923’, me nenin 4 “Objekti i veprimtarisë” dhe nenin 6 “Objekti” etj si dhe me nenin 41/2 të Statusit të Shoqërisë Aksionare ‘FK Tomori 1923’ SHA,

-Për mos realizim të ardhurash, çka nuk i ka shërbyer qëllimit të krijimit shoqërisë aksionare, në kundërshtim me nenin 3/9 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 i ndryshuar “Për sportin” .

19. J.S., me detyre **financier i KF Tomori**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e pagesave te paligjshme për vlerën 5,835,420 leke dem ekonomik, për disa futbolliste dhe trajnerë te KF, ne kushtet e gjendjes se vështire financiare dhe mungesës se ardhurave te veta si dhe mbulimit te shpenzimeve për paga nga buxheti i bashkise, për 3-mujorin e IV te vitit 2011, për vitin 2012 dhe 2013, ne kundërshtim me nenin 15 dhe 19 te VKM nr. 1619, date 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësisve qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve te organeve qeverisjes vendore”, me VKM nr. 566, date 14.7.2010, nr. 527, date 20.7.2011 dhe nr. 573, date 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi”, me nenet 97 dhe 160 “shpërblimi” etj te ligjit nr. 9901, date 14.4.2008 “Për Tregtaret e shoqëritë tregtare”, me nenin 18 “shoqëritë sportive” dhe nenin 36 kreu XI “Burimet e financimit” etj te ligjit nr. 9376, date 21.4.2005 “Për Sportin” i ndryshuar me ligjin nr. 9816, date 22.10.2007, me nenin 2 “Qëllimi i krijimit shoqërisë” dhe nenin 6 “Objekti” etj te Akt Themelimit te Shoqërisë Aksionare ‘FK Tomori 1923”, me nenin 4 “Objekti i veprimtarisë” dhe nenin 6 “Objekti” etj si dhe me nenin 41/2 te Statusit te Shoqërisë Aksionare ‘FK Tomori 1923” SHA,

-Për 9 raste shkelje me efekte financiare për vlerën 492,000 leke dem ekonomik, ne dieta dhe shpërblime, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, nënpika 3.2

-Për 3 shpërblime ne fund te vitit 2011 mbi limitin ligjor për vlerën 15,000 leke dem ekonomik, ne kundërshtim me kërkesat e pikës 6 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimit fondit veçantë” i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Besim Bileri, Milo Pano, Irma Shkupi dhe Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT